



BASHKIA  
TIRANË

REPUBLIKA E SHQIPËRISË  
BASHKIA TIRANË  
DREJTORIA E PËRGJITHSHME E PUNËVE PUBLIKE  
DREJTORIA E PROKURIMEVE

**Drejtuar:** Operatorit ekonomik “Emko” sh.p.k

**Adresa:** Tirane: Kashar Lagjja "Yzberisht", Rruga "Teodor Keko", Unaza e Re, Ndertese Private 1-kateshe, Zone Kadastrale Nr.3866, Numer Pasurie 315/173

**FORMULARI I NJOFTIMIT TË FITUESIT**

**1. Procedura e prokurimit: “Kërkesë për propozim”**

**Referenca e procedurës: REF-24833-05-30-2019**

**Përshkrim i shkurtër i kontratës:** “Blerje pajisje për zyrat për Bashkinë e Tiranës, për vitin 2019”.

**Kohëzgjatja e kontratës:** Operatori ekonomik fitues duhet të lëvrojë mallin brenda 4 (katër) javëve nga data e nënshkrimit të kontratës.

**Fondi limit:** 7.565.713 (shtatë milion e pesëqind e gjashtëdhjetë e pesë mijë e shtatëqind e trembëdhjetë) lekë pa tvsh

**Data e zhvillimit të procedurës së prokurimit: 10.06.2019, ora 11.00**

**Publikime të mëparshme:** Buletini i Njoftimeve Publike: Buletini Nr. 22 datë 03 Qershor 2019.

**Kriteret e përzgjedhjes së fituesit:** çmimi më i ulët X

Njoftojmë se, ka qënë pjesëmarrës në procedurë ofertuesi ekonomik me vlerën përkatëse të ofruar si më poshtë:

**1- Operatori ekonomik “EMKO” shpk** NUIS K61424016V

Vlera e ofertës pa TVSH– **6.975.000** (gjashtë milion e nëntëqind e shtatëdhjetë e pesë mijë) lekë

Vlera e ofertës me tvsh– **8.370.000** (tetë milion e treqind e shtatëdhjetë mijë) lekë.

**2- Operatori ekonomik “Muça” shpk** NUIS K01421002H

Vlera totale e ofertës: 0 (zero) lekë.

**3- Operatori ekonomik “PAERA” shpk** NUIS L31505034R

Vlera e ofertës pa TVSH– 5.828.000 (pesë milion e tetëqind e njëzet e tetë mijë) lekë

Vlera e ofertës me tvsh– 6.993.600 (gjashtë milion e nëntëqind e nëntëdhjetë e tre mije e pesëqind) lekë.

**Janë skualifikuar ofertuesit e mëposhtëm:**

**1. Operatori Ekonomik “Muça” shpk**

**NUIS K01421002H**

**Përkatësisht për arsyet e mëposhtme:**

Pas hapjes së ofertave, Komisioni i Vlerësimit të Ofertave konstatoi se shoqëria “Muça” shpk nuk ka paraqitur në sistemin elektronik dokumentacionin e plotë ligjor e teknik dhe oferten ekonomike të kërkuar tek kriteret e vecanta për kualifikim pjesë përbërëse e dokumenteve të tenderit për këtë procedurë.

Ky fakt i konstatuar nga KVO-ja u regjistrua në procesverbalin e vlerësimit të Ofertave.

Për sa më sipër, Operatori Ekonomik “Muça” shpk s’kualifikohet pasi nuk ka paraqitur dokumentacionin e plotë ligjor, teknik dhe ekonomik kërkesa këto të përcaktuara në Kriteret e Përgjithshme të Kualifikimit dhe Kriteret e Veçanta të Kualifikimit e dokumenteve standarte të tenderit për këtë procedurë.

Komisioni i Vlerësimit të Ofertave nga shqyrtimi i kësaj oferte në mbështetje të pikës 5, të nenit 53, të Ligjit 9643, datë 20.11.2006, për “Prokurimin publik”, i ndryshuar dhe mbështetje të Kreu VII, neni 66, pika 3, të VKM nr.914, datë 29.12.2014 për “Miratimin e rregullave të prokurimit publik”, e shpall të pavlefshme këtë ofertë pasi nuk plotëson kërkesat e përcaktuara në dokumentet e tenderit.

**2. Operatori Ekonomik “PAERA” shpk**

**NUIS L31505034R**

**Përkatësisht për arsyet e mëposhtme:**

Pas hapjes së ofertave, Komisioni i Vlerësimit të Ofertave konstatoi se shoqëria “Paera” shpk nuk është paraqitur në datën dhe orën e caktuar nga AK për paraqitjen e mostrave.

OE “Paera” shpk nuk plotëson kriterin “Kriteret e përgjithshme të pranimit dhe kualifikimit”, të cilat plotësohen nepermjet shtojces 5 të DST: Deklaratë për përmbushjen e kriterëve të përgjithshme të pranimit/kualifikimit, nuk është e plotësuar sipas standartit të kërkuar në DST. OE ka detyrimin ligjor të plotësojë deklaratën për përmbushjen e kriterëve të përgjithshme sipas shtojces 5 të DST, duke mos deklaruar edhe personat e tjerë (sipas ekstratit të QKB). Në shtojcën 5 citohet se:.....

Personi/at në cilësinë e **anëtarit të organit administrativ, drejtuesit ose mbikëqyrësit, aksionerit ose ortakut, ose ka kompetenca përfaqësuese, vendimmarrjeje ose kontrolluese brenda operatorit ekonomik**, si më poshtë:

\_\_\_\_\_  
\_\_\_\_\_  
\_\_\_\_\_ etj.

nuk janë ose kanë qenë të dënuar me vendim gjyqësor të formës së prerë për asnjë nga veprat penale, të përcaktuara në nenin 45/1 të LPP [...]

OE “Paera” shpk nuk plotëson pikën 2.3 “Kapaciteti teknik”: “Operatori ekonomik duhet të paraqesë **dëshmi për furnizimet e mëparshme, të ngjashme me objektin e prokurimit, të realizuara gjatë tre viteve të fundit nga data e zhvillimit të tenderit, me një vlerë jo më të vogël se 40% e vlerës së përlllogaritur të kontratës që prokurohet ose 3.026.285 (tre milion e njëzetë e gjashtë mijë e dyqind e tetëdhjetë e pesë) lekë pa tvsh**”, pasi faturat tatimore të dorëzuara për përmbushjen e këtij kriteri kapin vlerën 2.452.770 leke pa tvsh në total, nderkohe që në kriteret e vendosura nga AK në DST është kërkuar **40% e vlerës së**

*përlllogaritur të kontratës që prokurohet ose 3.026.285 lek pa tvsh.*

OE "Paera" shpk nuk ploteson piken 2.3.2 "Kapaciteti teknik": "[..... të paktën një punonjës duhet të jetë i punësuar si inxhinier druri, i pajisur me kontratë pune të vlefshme, diplomë universitare, i përfshirë në listëpagesat e shoqërisë....]

OE "Paera" shpk nuk ploteson piken 2.3.3 "Kapaciteti teknik": "Operatori ekonomik duhet të paraqesë një deklaratë me anë të së cilës merr përsipër të kryej shërbimin e transportit, furnizimin me produktet e kërkuara si dhe montimin e tyre me shpenzimet e tij në vendndodhjen e autoritetit kontraktor, sipas kërkesës së AK"

OE "Paera" shpk nuk ploteson piken 2.3.8 "Kapaciteti teknik": „Operatori ekonomik duhet të paraqesë certifikatat per cilësinë e produktit sipas standarteve si më poshte vijon: **Karrige: EN 1335-1:2000, EN 1335-2:2009, EN 1335-3:2009**

OE "Paera" shpk nuk ploteson piken 2.3.9 "Kapaciteti teknik": "Operatori ekonomik duhet të paraqesë mostra (një copë) sipas specifikimeve teknike të dhënë në DST të cilat duhet të dorëzohen në ditën dhe orën e hapjes së ofertave pranë AK (Drejtoria e Prokurimeve)

OE "Paera" shpk nuk ploteson piken 2.3.10 "Kapaciteti teknik": „Operatori ekonomik duhet të deklarojë garancinë e mallrave e cila duhet të jetë jo më pak se 1 (një) vit, gjatë së cilës ofertuesi do të sigurojë riparimin, mirëmbajtjen dhe shërbimin pa pagesë konform specifikimeve teknike“.

OE "Paera" ka dorezuar nje deklaratë ne te cilen shprehet se: [.....] *del e panevojshme, jo ligjore dhe diskriminuese, kërkesa per te pasur nje inxhinier te punësuar,si dhe paraqitjen e nje mostre per secilin nga artikujt e kerkuar ne kete procedure. Neve nuk mund te sjellim mostra pasi keto artikuj I importojme ne perputhje me kërkesat dhe specifikimet teknike se nuk do te sjelle mostra dhe inxhinier pasi i gjykon diskriminuese .....*”

OE "Muca" shpk gjate afatit të njoftimit të kontratës konform nenit 63 pika 1.1 e ligjit Nr 9643 dt 20.11.2006 për "Prokurimin Publik" (i ndryshuar) dhe nenit 78 pika 4 e VKM Nr 914 dt 29.12.2014 për "Miratimin e rregullave të prokurimit publik" (i ndryshuar) nuk i ka kontestuar përmes procesit të ankimit kriterin/ et në fjalë të vendosura nga autoriteti kontraktor në dokumentat e tenderit, megjithëse ka patur në dispozicion momentin procedural të paraqitjes së ankesës në lidhje me pretendimet e tyre parashikuar nga neni 63 pika 1/1 e LPP.

Përsa më sipër, Operatori Ekonomik "Paera" shpk s'kualifikohet pasi nuk plotëson kriteret për kualifikim, kërkesa këto të përcaktuara në Kriteret e Kriteret e Veçanta të Kualifikimit, Kapaciteti teknik, "Kërkesat teknike specifike" e dokumenteve standarte të tenderit për këtë procedurë.

Komisioni i Vlerësimit të Ofertave nga shqyrtimi i kësaj oferte në mbështetje të pikës 5, të nenit 53, të Ligjit 9643, datë 20.11.2006, për "Prokurimin publik", i ndryshuar dhe mbështetje të Kreu VII, neni 66, pika 3, të VKM nr.914, datë 29.12.2014 për "Miratimin e rregullave të prokurimit publik", e **shpall të pavlefshme këtë ofertë** pasi nuk plotëson kërkesat e përcaktuara në dokumentet e tenderit.

Duke iu referuar procedurës së lartpërmendur, informojmë operatorin ekonomik "**Emko**" **shpk**, me adresë: Tirane Kashar Lagjja "Yzberisht", Rruga "Teodor Keko", Unaza e Re, Ndertese Private 1-kateshe, Zone Kadastrale Nr.3866, Numer Pasurie 315/173, se oferta e paraqitur, me një vlerë të përgjithshme prej **6.975.000 (gjashtë milion e nëntëqind e shtatëdhjetë e pesë mijë) lekë pa TVSH është identifikuar si oferta e suksesshme.**

Rrjedhimisht, jeni i lutur të paraqisni pranë Drejtorisë së Prokurimeve, Bashkia e Tiranës, Sheshi Skënderbej, Nd. 2, Kodi postar 1001, Tirane, sigurimin e kontratës, siç parashikohet në dokumentat e tenderit, brenda 60 (gjashtëdhjetë) ditëve nga dita e marrjes/publikimit të këtij njoftimi.

Në rast se nuk pajtoheni me këtë kërkesë, ose tërhiqeni nga nënshkrimi i kontratës, do të konfiskohet sigurimi i ofertës suaj (nëse është kërkuar) dhe kontrata do t'i akordohet ofertuesit vijues në klasifikimin përfundimtar nëse ka, oferta e të cilit është dorëzuar me një vlerë të përgjithshme prej *[nuk plotësohet kufiri i lejuar sipas ligjit për diferencën e vlerës]*, siç parashikohet në nenin 58 të Ligjit nr.9643 datë 20.11.2006 “Për prokurimin publik”, i ndryshuar.

**Njoftimi i Klasifikimit është bërë në datë: 19.07.2019.**

**Ankesa:** Gjatë afatit ligjor për pritjen e ankesave nga shoqëritë pjesëmarrëse në tender në mbështetje të Nenit 63 të Ligjit Nr. 9643, datë 20.11.2006 “Për Prokurimin Publik” (i ndryshuar) si dhe në bazë të Kreut X, Neni 78 të VKM-së Nr. 914 datë 29.12.2014 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, pranë Autoritetit Kontraktor, Bashkia Tiranë, **nuk është paraqitur asnjë ankesë.**